



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 51, Datë 20.02.2023

MBI

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY24”  
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “f”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.02.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 593/2 prot., datë 15.02.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy24” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Energy 24” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 593 prot., datë 07.02.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Energy24” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; për pikën 2.4, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:  
*Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*
  - **gërma “a”:** Konstatohet se dokumenti “Detyrimet në kohë reale” nuk është ai i lëshuar sipas kërkesës së kësaj pike të rregullores dhe në vijim do t’i kërkohet shoqërisë ta përcjellë atë në ERE, Vërtetimin për shlyerjen e Detyrimeve Tatimore dhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore.
  - **gërma “b”:** Në përmbushje të kërkesave të kësaj pike të rregullores, t’i kërkohet shoqërisë që të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të vitit 2021 në format origjinal/fotokopje të njësuar me origjinalin dhe gjithashtu të depozitojë pasqyrat financiare për vitet 2019 dhe 2020 të cilat mungojnë. Po ashtu shoqëria duhet të dokumentojë/depozitojë në ERE dokumentacion vërtetues (si psh vërtetim llogarie bankare, apo hua/kredi) mbi disponimin nga ana e saj e vlerës financiare për të realizuar të paktën një muaj aktivitetin për të cilën kërkon të licencohet.
  - **gërma “c”:** Shoqëria ka depozituar në ERE një Plan Biznesi i cili nuk i përket ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit, por veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për këtë arsye t’i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE, Planin e Biznesit për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në kuadër të mos plotësimit nga Aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mos fillimi i procedurës për këtë aplikim.
- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10 pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për alikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy24” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të bordit të ERE-s dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**